



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____/2022

Datë: 07.02.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe nën nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.02.2022 pas diskutimit lidhur me pikën e 11 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale-Parkingu, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale Parkingu në parcelën Nr. P-70705029-00468-24, me sipërfaqe prej 3185m², Zona Kadastrale Gjakovë-Qytet, me këtë përbërje :
 1. Znj. Adelina Shehu –Kola, përfaqësuese e Ekzekutivit të Komunës .
 2. Z. Shkumbim Kastrati, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
 3. Znj. Teuta Pallaska-Milla, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
 4. Z. Bashkim Gashaj, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
 5. Z. Arbër Xharra, përfaqësues i sektorit jo qeveritar .
2. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së paluajtshme Komunale për pronën e cekura në pikën 1 të këtij vendimi për të cilin është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Anëtareve të Komisioni
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Znj. Arbënësja Kuqi

